

V E N D I M
Nr.15, datë 8.11.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Metush Saraçi,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 2.10.1995, 18.10.1995 dhe 8.11.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 16 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S A : 1. ORGANIZATA E VETERANEVE TE LUFTES

ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i këtij Komiteti Qamil Poda dhe juristja Ylbere Malindi.

2. ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LANÇ (Dega e Tiranës), e përfaqësuar nga Josif Zegali e Islam Blushi.

PERSON I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Z. Bardhyl Shehu e Sali Onuzi.

O B J E K T I

Shfuqizimi i pikave 6, 7, 9, 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 dhe pikës 13 të udhëzimit të Ministrit të Mbrojtjes nr.335, datë 23.6.1995, sepse vijnë në kundërshtim me ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Organizata e Veteranëve të LANÇ-it ka parashtruar se Këshilli i Ministrave, duke i ndarë veteranët në kategori dhe duke ju caktuar atyre masa shpërblimi të ndryshme sipas pikës 7 të vendimit të tij nr.190, datë 3.5.1995, ka tejkaluar kompetencat që i ka dhënë ligjvënësi, i cili në nenin 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 ka përcaktuar: “Këshilli i Ministrave cakton një shpërblim mujor për personat që gëzojnë statusin e veteranit, për ata që gëzojnë statusin e invalidit të Luftës si dhe për të internuarit në kampet e përqendrimit nazifashist”.

Gjykata çmon se Këshilli i Ministrave, duke i ndarë veteranët në grupe për efekt të përcaktimit të masës së shpërblimit mujor, me të drejtë është mbështetur në normën e nenit 2 të Ligjit, ku përcakton llojet e aktivitetit që duhet të kenë kryer personat e ndryshëm gjatë pjesëmarrjes së tyre në luftën kundër pushtuesve nazifashistë për të përfutur statusin e veteranit.

I drejtë është edhe përcaktimi nga Këshilli i Ministrave i masave të ndryshme të shpërblimit për luftëtarët e inkuadruar në njësitë e armatosura në luftën kundër pushtuesve nazifashistë, duke u nisur nga koha e aktivizimit të tyre në këto njësi.

Gjykata e gjen të bazuar kërkesën e Organizatës së LANÇ-it se Këshilli i Ministrave nuk ka vlerësuar drejt meritat e veteranëve që kanë zhvilluar veprimtari të organizuar në ilegalitet në prapavijë të armikut dhe të kryefamiljarëve të atëhershëm të familjeve të njohura si baza të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, duke ju caktuar atyre, sipas gërmës “d” të pikës 7, një shpërblim deri tre herë më të vogël se veteranëve të inkuadruar në formacionet luftarake.

Nga përmbajtja e neneve 2 dhe 8 të ligjit, trajtohen njëjloj si veteranët që kanë qenë të

inkuadruar në formacionet luftarake, ashtu edhe veteranët që kanë zhvilluar kativitetin e tyre në ilegalitet në prapavijë të armikut dhe kryefamiljarët e atëhershëm të familjeve të njohura si baza të luftës kundër pushtuesve nazifashistë.

Në këto rrethana gërma “d” e pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave në shqyrtim është e papajtueshme me ligjin.

Gjithashtu, Gjykata i gjen të drejta parashtrimet e të dyja organizatave kërkuese se Këshilli i Ministrave ka dalë jashtë kompetencave të tij duke përcaktuar në pikën 9 të vendimit: “të internuarit në kampet e përqëndrimit nazifashistë të shfarosjes në masë”, ndërkohë që në nenin 8 të ligjit thuhet shprehimisht: “të internuarit në kampet e përqëndrimit nazifashist”, pa bërë dallim ndërmjet kampeve të shfarosjes në masë dhe kampeve të tjerë. Në këtë mënyrë Këshilli i Ministrave duke ngushtuar rrethin e personave që përfshin ligji, ka lënë pa ju caktuar shpërblim mujor si veteranë të internuarve në kampet e përqëndrimit që nuk janë cilësuar të shfarosjes në masë.

Prandaj, edhe pika 9 e vendimit nuk pajtohet me ligjin.

Gjykata e gjen të bazuar kërkesën e OBVL-së për Tiranën që dhënia e shpërblimit mujor veteranëve mos të kushtëzohet me qënien e veteranit në pension pleqërie, siç përcaktohet në paragrafin e parë të pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995: “Shpërblimi i veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë jepet mbi pensionin e pleqërisë dhe kompensimet e tjera që mund të marrin...”.

Shpërblimi mujor u jepet veteranëve për kontributin që ata kanë dhënë për çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë dhe nuk ka të bëjë aspak as me moshën as me qënien e tyre apo jo në pension. Një kufizim të tillë nuk e ka bërë ligji nr.7874, datë 17.11.1994, në zbatim të të cilit ka dalë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995.

Të bazuar e gjen Gjykata edhe kërkesën e të dyja organizatave të veteranëve për shfuqizimin e fjalisë së fundit të pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995. Ndërsa paragrafi i tretë i nenit 8 të ligjit parashikon dhënien e shpërblimit të menjëhershëm familjeve të veteranëve, Këshilli i Ministrave në vendimin e tij pa të drejtë kufizon rrethin e personave të familjes.

Gjithashtu, duhet pranuar kërkesa e Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it se Këshilli i Ministrave me fjalët “e rënda” në pikën 6 të vendimit të tij, ka dalë tej përmbajtjes së nenit 6 të Ligjit, i cili përcakton : “Statusin e veteranit nuk e gëzojnë personat që janë dënuar ose dënohen me vendim të gjykatës për krime kundër lirisë dhe pavarësisë së Atdheut dhe kriminelë në Luftën genocide të klasave në regjimin totalitar”.

Ndryshe nga sa parashtrohet në kërkesën e Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it, Këshilli i Ministrave me vendimin nr.540, datë 9.10.1995 ka miratuar përbërjen e Komisionit Qendror dhe të komisioneve të rretheve për dhënien e statusit të veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, sipas listave që i bashkëngjiten atij vendimi, duke zbatuar kështu nenin 4 të Ligjit.

Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon Organizata e Veteranëve të LANÇ-it në kërkesë, në Udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr.335, datë 23.6.1995, nuk ka asnjë dispozitë ku të parashikohet që degët ushtarake në rrethe të pranojnë si anëtarë të komisioneve për dhënien e statusit vetëm veteranë nga OBVL-ja dhe mos të pranohen veteranë nga Organizata e Veteranëve të LANÇ-it.

Sipas nenit 3 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 qënia veteran i Luftës kundër pushtuesve nazifashistë vërtetohet, ndër të tjera (gërma “d”) edhe “me çdo dokument tjetër zyrtar që vërteton pjesëmarrjen në Luftën kundër pushtuesve nazifashistë”. Në këtë kontekst, përmbajtja e pikës 13 të udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr.335, datë 23.6.1995 se : “Në kuptim të gërmës “d” të nenit 3 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 pranohen si dokumente edhe vërtetimet e bazuara mbi të dhënat e dosjeve personale lëshuar nga Arkivi i Shtetit, Arkivi i Ushtrisë, nga Drejtoria e Personelit të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Brendshme e të dikastereve të tjera”, nuk i bën ndonjë kufizim Ligjit, siç pretendon në kërkesën e saj Organizata e Veteranëve të LANÇ-it.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24, (pikat 2 dhe 3) dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Të shfuqizojë si të papajtueshme me ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 që vijojnë :

1. Gërmën “d” të pikës 7;
2. Pikën 9;
3. Fjalët : “mbi pensionin e pleqërisë dhe kompensimet e tjera që mund të marrin” të paragrafit të parë të pikës 7;
4. Fjalinë : “Këtë shpërblim e përfitojnë bashkëshortët, prindërit ose fëmijët e paaftë për punë”, të pikës 13;
5. Fjalët : “e rënda”, të pikës 6.

Këshilli i Ministrave të nxjerrë dispozita në vend të gërmës “d” të pikës 7 dhe pikës 9 të shfuqizuara.

Rrëzimin e kërkesave për pjesët e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi të nesërmen e botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 8.11.1995